

1. Raportimi javor per periudhen 10 deri 16 Qershor 2019

Raporti i Dyte javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: Eleonora Olli
Zgjedhjet: Per Kryetar Bashkie ne date 30 Qershor 2019
Partia/subjekti elektoral: Partia Aleanca Kuq e Zi
Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara: **Korçe,Pogradec,Prrenjas**

Shkeljet e mundëshme të identifikuara të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore

Zyrat elektorale

Rreth 35% e bashkive ne vend (nga 61 te kontaktuara zyrtarisht) jane pergjigjur me (e-mail,poste) se :

Partia Aleanca Kuq e Zi nuk ka zyra elektorale ne keto Bashki,
Partia Aleanca Kuq e Zi nuk ka derguar njoftim prane bashkise per vendodhje te zyrave elektorale,
Nga verifikimet ne terren I punonjesve te Bashkise nuk jane evidentuar zyra elektorale te Partise Aleanca Kuq e Zi.

Monitoruesi ka vazhduar komunikimin me kryetarin e partise Aleanca Kuq e Zi dhe eshte ne pritje per te marre zyrtarisht listen e aktiviteteve per fushaten zgjedhore Qershor 2019 nga Partia Aleanca Kuq e Zi.

Ne javen e dyte jane monitoruar Bashkite Korçe,Pogradec,Prrenjas.

Gjate monitorimit nuk jane vene re shkelje ne lidhje me zyrat elektorale.



Materiale të fushatës të ndaluara

Ne javën e dytë janë monitoruar Bashkitë Korçë, Pogradec, Prrenjas. Gjatë monitorimit nuk janë vënë re shkelje në lidhje me materialet e ndaluara të fushatës dhe për rrjedhim nuk ka kosto të mundshme të materialeve të ndaluara të vërejtura gjatë fushatës .Nga Partia Aleanca Kuq e Zi nuk është marrë ende lista e aktiviteteve elektorale për secilin Bashki në vend.

Ne javën e dytë të monitorimit në qytetet Korçë, Pogradec, Prrenjas nuk u evidentuan tubime ose mitingje zgjedhore të Partisë Aleanca Kuq e Zi.

Tiranë 16 Qershor 2019

Monitorues/ Eleonora Olli



Miratur me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019